

# 11

## MISIONI I KISHËS SË JEZUSIT

Mund të përmendim<sup>1</sup> edhe karakteristika të tjera dalluese të kishës së Jezusit, por do të diskutojmë vetëm njërën prej tyre. Pastaj do ta përfundojmë këtë pjesë të studimit tonë.

### THIRRJA NDAJ KISHËS PËR TË VEPRUAR

Kisha është një institucion i shenjtë dhe misioni i saj është po aq i shenjtë. Jezusi e përkufizoi misionin e tij me këto fjalë: “Sepse Biri i njeriut erdhi të kërkojë dhe të shpëtojë atë që kishte humbur” (Luka 19:10). Kisha e tij ka të njëjtin synim. Shumë synime janë të rëndësishme, por vetëm një është i domosdoshëm: të shkuarit në qiell. “Ç’përfitim ka njeriu nëse fiton gjithë botën dhe pastaj e humb shpirtin e vet?” (Mateu 16:26a).

Detyra e kishës që “të shpëtojë atë që kishte humbur” mund të ndahet të paktën në tri përgjegjësi:

1. *Ungjillizimi*. Fjala “ungjillizoj” do të thotë “të tregosh lajmin e mirë për Jezusin”. Detyra për të ungjillizuar u dha në porosinë e madhe të Jezusit:

... “Shkoni, pra dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës” (Mateu 28:19, 20).

... “Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijese; ai që beson dhe është pagëzuar, do të jetë i shpëtuar; por ai që nuk ka besuar, do të jetë i dënuar” (Marku 16:15, 16).

Çdo kristian duhet t’u mësojë atyre që takon të vërtetën për Jezusin dhe rrugën e tij.

2. *Ndërtimi*. Fjala “ndërtoj” do të thotë “ngre moralisht”. Kristianët duhet ta ngrenë njëri-tjetrin moralisht me anë të mësimin dhe inkurajimit. Një nga vargjet ku gjendet kjo thirrje është Efesianëve 4:15, 16:

Por, duke thënë të vërtetën me dashuri, të rritemi në çdo gjë drejt atij që është kreu, Krishti. Prej të cilit gjithë trupi, i lidhur mirë dhe i bashkuar, me anë të kontributit që jep çdo gjymtyrë dhe sipas forcës së çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri.

3. *Bamirësia*. Fjala “bamirësi” do të thotë të ndihmojmë të tjerët, sepse u “duam të mirën”. Bamirësia zakonisht përfshin plotësimin e nevojave, ku përfshihen nevojat fizike të tilla si ushqim e veshmbathje. Shumë vargje në Dhjatën e Re flasin për përgjegjësinë për të ndihmuar të tjerët.

Prandaj, sa të kemi rast, le t’u bëjmë të mirën të gjithëve, por në radhë të parë atyre që janë në familjen e besimit (Galatasve 6:10).

Është e lehtë që një bashkësi kristianësh të harrojë misionin e saj të parë, të dhënë nga Perëndia, ungjillizimin, duke u marrë me çështje që mund të jenë të mira e të rëndësishme, por jo të rëndësishme së dorës së parë.

### NJË THIRRJE PËR JU

Në mënyrë që studimi ynë të jetë efektiv, ai duhet të jetë personal dhe praktik. Dua që ju të rishikoni gjashtë mësimet për kishën e Krishtit (duke përfshirë edhe këtë mësim). Pastaj do të doja që të krahasoni disa organizata fetare me atë që Dhjata e Re mëson për kishën e Zotit. Për efekt të këtij ushtrimi, nuk ka rëndësi se çfarë organizate zgjidhni. (Mund të jetë një që ju pëlqen apo një që

nuk ju pëlqen.) Ky ushtrim do t'ju nxisë të dalloni njëren organizatë nga tjetra (jo vetëm nga emri). Për krahasimin që do të bëni mund t'ju vijë në ndihmë një listë pyetjesh.

Mund të doni të bëni pyetje të përgjithshme si këto:

- A është kjo një kishë që ka frikë nga Perëndia dhe që beson te Perëndia, te Jezusi dhe te Bibla?
- A është kjo kishë e angazhuar të kënaqë Perëndinë dhe të forcojë njerëzit?

Gjithashtu, mund të doni të bëni pyetje më të detajuara, duke u nisur nga studimi ynë

- A mban kjo kishë një emërtim biblik?
- A është kjo kishë e organizuar bibli-kisht?
- A quhen predikuesit e saj “barinj” (pastorë)? A mbajnë ata tituj jobiblikë si “i adhuruar”?
- A adhuron kjo kishë sipas shkrimeve? A e feston Darkën e Zotit në ditën e parë të çdo jave, të dielën? A përdor vetëm muzikë vokale (këngë pa shoqërimin e instrumenteve muzikorë) në adhurimin e saj?

Ndërsa bëni listën e pyetjeve, mos harroni të bëni ato pyetje që lidhen me zemrën e kishës. Jezusi tha:

... “Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde.” Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten” (Mateu 22:37–39).

Do të donit të punonit dhe të adhuronit aty ku do të ishit të inkurajuar për të zbatuar urdhërime si këto?

Si pjesë të fundit të këtij ushtrimi, krahasoni listën e pyetjeve me një kishë lokale të Krishtit. Kishat e Krishtit pretendojnë të kenë restauruar kishën e shekullit të parë. Kishat e Krishtit pohojnë se “flasin aty ku Bibla flet” dhe “heshtin aty ku Bibla hesht”. Ju ftoj që t’i shqyrtoni pretendimet e tyre (Veprat 17:11).

## KONKLUZION

Kisha e Jezusit ishte pjesë e “qëllimit të përgjeshëm” të Perëndisë (Efesianëve 3:10, 11). “Dituria e shumëllojshme e Perëndisë” është manifestuar “nëpërmjet kishës” (Efesianëve 3:10). Lavdia e Perëndisë ndriçon në kishë (Efesianëve 3:21). Kisha është “shtylla dhe mbështetja e së vërtetës” (1 Timoteut 3:15). Shpresoj që studimi ynë për kishën të ketë bërë që ta vlerësoni më shumë atë. Ajo është një nga përgatitjet më të shquara dhe më të mrekullueshme të Perëndisë.

Është e rëndësishme ta identifikojmë, ta gjejmë kishën e Zotit në ditët e sotme dhe të jemi pjesë e saj. A të huton shumëllojshmëria e kishave që ekzistojnë? Po. A është e lehtë të gjesh kishën e Jezusit në mes të kësaj rrëmuje? Jo. Megjithatë, me ndihmën e Perëndisë, mund ta gjeni atë. Jini optimistë si Pali, i cili tha: “Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon” (Filipianëve 4:13).

---

<sup>1</sup> Karakteristikat dalluese të kishës së Zotit mund të përfshijnë kohën në të cilën ajo u krijua si dhe vendin në të cilin u krijua (Veprat 2) dhe theksin në faktin se kisha është një dhe e pandarë (Gjoni 17:20, 21; 1 Korintasve 1:10–13; Efesianëve 4:4–6).

Autor: *David Roper*  
Marrë nga studimi: *“Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve”*  
© 2001, 2003 E VERTETA PËR SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara